

DT 29/3/2024  
N 126 PRO

**Drejtuar:** Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar  
Presidentit dhe Personave te ngarkuar me Drejtimin

**Lenda:** Dorezim i Raportit te Audituesit te pavarur per Pasqyrat Financiare te vitit ushtrimor te mbyllur me 31.12.2023.

I nderuar Z.Ylli,

Ne zbatim te kontrates se sherbimit lidhur me 14.09.2021, si dhe letres se angazhimit lidhur ne dhjetor 2023, ndermjet meje si Auditues Ligjor dhe Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar per auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2023, bashkelidhur do te gjeni raportin e auditimit dhe letren per drejtimin e KOKSH.

Referuar Letres se Angazhimit, fatura do te gjenerohet ne sistemin on-line te faturimit.

Me respekt,

Auditues Ligjor

Tirane me 29.03.2024

Ludmilla Paluka



DT 29 /31/2024

N 120/1 PRO

## RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Drejtuar: Asamblese se Pergjithshme te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar.

### Opinion i pakualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar-KOKSH, Organizate jo fitimprurese, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2023, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

*Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pasqyrën e pozicionin financiar të KOKSH, pasqyrën e aktiviteteve dhe flukset e parasë me datën 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit per OJF-te, si dhe kerkesave te .*

*Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga KOKSH në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.*

### Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje ne nuk japim një opinion të veçantë.

### Çeshtje te tjera

Me Vendimin Nr.893 datë 27/12/2022 , dhe në shtese te tij me Vendimin Nr.709 datë 06/12/2023 Qeveria akordoi një fond prej 600.000.000 Lekë për Projektin “Ekipet Sportive në Shkolla” në mbështetje dhe masivizimin te ekipeve sportive të volejball e basketbollit nëpër shkollat e gjithë Republikën.



## **Përgjegjësitë e Administratorit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi (Komiteti Ekzekutiv dhe Staf) është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të për OJF-te, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit.

Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikime, përvetesime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.




- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale për aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimesi veprimtarinë e saj. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Auditues Ligjor

Ludmilla Paluka



*Tiranë, më 29 Mars 2024*